

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-ës
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-004/2015

**Prishtinë
12 Tetor 2016**

Në çështjen juridike të:

K. M.

Pala ankuese

kundër

Nuk ka

Kolegji i Apelit të AKP-së të Gjykatës Supreme të Kosovës duke vendosur me gjyqtarët Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit, Beshir Islami dhe Krassimir Mazgalov, anëtarë, në ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/239/2014 (lënda e regjistruar në AKP me numër KPA54910), të datës 30 Prill 2014 pas shqyrtimit të mbajtur më 12 Tetor 2016, mori këtë

AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e K. M., e paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/239/2014, i datës 30 Prill 2014 për sa i përket lëndës së regjistruar në Agjencinë Kosovare të Pronave me numër KPA54910.
2. Konfirmohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/239/2014, i datës 30 Prill 2014 për sa i përket lëndës së regjistruar në Agjencinë Kosovare të Pronave me numër KPA54910.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 30 Dhjetor 2007 K. M. (në tekstin e mëtejme: pala ankuese) ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), ku kërkon vërtetimin e të drejtës pronësore dhe ririposimin e banesës në sipërfaqe prej 34.81 m², që ndodhet në rrugën, Kralja Petra I bb kati tretë banesa nr. 9, Komuna e Ferizajit (në tekstin e mëtejme: prona e kërkuar). Ajo pretendon se pronën e kërkuar e ka fituar me ndarje nga dhënësi i banesës dhe më pastaj ajo e ka blerë atë.
2. Për të mbështetur kërkesën e saj, ajo ka dorëzuar në AKP dokumentet vijuese:
 - Vendim mbi Ndarje dhe Shfrytëzim të pronës së kërkuar lëshuar nga Komuna e Ferizajt Nr. 360-37 datë 26.01.1999
 - Kontratë e Shitblerjes për banesës Ov..Br.18/99 e lidhur mes Kuvendit Komunal të Ferizajt si shitës dhe Palës Ankuese me datë 16 Mars 1999
 - Deklaratë e ish fqinjës J. D. e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Knjazevc Ov.Br.240/07
 - Deklaratë e ish fqinjit B. R. e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Krusevac Ov.Br.383/07
 - Deklaratë e ish fqinjit P. S. e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Mitrovicë Leg.nr. 179/2007

- Vërtetim Su.Br.1/07 dt. 10.01.2007 të lëshuar nga Gjykata paralele komunale e Ferizajt e dislokuar në Leskovc që dëshmon se Kontrata e Shitblerjes është lidhur në këtë gjykatë paralele.
 - Dokument identifikimi lëshuar nga organet e Republikës së Serbisë me 25.06.2003
3. Më 27 Qershor 2007 AKP-ja ka bërë identifikimin e pronës së kërkuar. Prona doli të jetë e uzurpuar nga F. Sh., i cili ka deklaruar se është vendosur në këtë pronë pas konfliktit të armatosur pasi familja e tij nuk kishte strehim dhe se pronë ka qenë e pa banuar sepse banesa ishte e pa përfunduar dhe ai ka investuar me mjete vetanake duke e bërë atë të banueshme.
 4. Pasi që asnjë palë nuk ka paraqitur përgjigje në kërkesë brenda afatit ligjor prej 30 ditëve, në pajtim me nenin 10.2 të Ligjit nr. 03/L-079, kërkesa është konsideruar si e pakontestueshme.
 5. Sipas raportit të verifikimit të datës 29.10. 2008, dokumentet e bashkangjitura, nuk janë gjetur te institucionet kompetente, prandaj, verifikimi i këtyre dokumenteve ishte negativ.
 6. AKP-ja ka vërtetuar se banesa ka qenë objekt shqyrtimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore Banesore i themeluar me UNMIK/REG/1999/23 dhe UNMIK/REG/2000/60 me kërkesë të K. M.DS605373. Kërkesa është hedhur poshtë nga KKPJB-ja me vendimin e vet nr. HPCC/D/189/2005/C, i datës 30 prill 2005.
 7. AKP-ja ka kontaktuar disa herë Palën Ankuese dhe ka kërkuar dokumente tjera për të vërtetuar pronësisë e pretenduar ndaj pronës së kërkuar. Sipas të dhënave në dosje të AKP-së, ajo është informuar se dokumentet të cilat i ka dorëzuar për këtë qëllim, nuk janë gjetur në të dhënat publike dhe një njoftim për pranueshmërinë potenciale është dërguar duke kërkuar nga ajo dokumentet e nevojshme. Ajo ka dorëzuar dokumentet e njëjta rreth titullit të pronësisë të cilat veçse janë tentuar të verifikohen më parë nga KKPJB-ja dhe është konstatuar se nuk janë gjetur. Ajo e ka konfirmuar se nuk kishte dokumente tjera për t'i dorëzuar.
 8. Më 30 Prill 2014, Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës (KKPK), me vendimin e vet KPCC/D/R/239/2013, e ka refuzuar kërkesën. Në paragrafin 10 dhe 26 në vendimin grupor, i cili sipas vendimit të vërtetuar zbatohet në veçanti për kërkesën, thuhet se dokumentet të cilat i ka dorëzuar paraqitësi i kërkesës, nuk janë verifikuar si origjinale nga Sekretaria Ekzekutive. Paraqitësi i kërkesës tutje ka dorëzuar deklaratat me shkrim, të bëra nga tre dëshmitarë, që vërtetojnë se ai ka jetuar në pronën e kërkuar në vitin 1999. Në pikëpamje të Komisionit, këto deklarata, në mungesë të provave vërtetuese, nuk janë prova

të mjaftueshme për të vërtetuar pronësinë ndaj pronës së kërkuar. Si rrjedhojë, kërkesa duhet të refuzohet..

9. Vendimi i është dorëzuar K. M., më 15 Korrik 2014. Pala ankuese ka ushtruar aknes me 14 gusht 2014 duke e dorëzuar atë në Zyrën përkatëse në Beograd dhe më pastaj e njëjta i është përcjellë AKP-së me 18 Gusht 2014.
10. Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe pretendimeve ankimore sipas nenit 194 të Ligjit Nr. 03/L-006 mbi procedurën kontestimore (Gaz. Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.38/2008) (në tekstin e mëtejme LPK), Gjykata lidhur me shqyrtimin e aktgjykimit sipas detyrës zyrtare dhe për shkaqet e cekura dhe jo të cekura në ankesë gjeti se Ankesa është e pa bazuar

Pretendimet e palës ankuese

11. Në kërkesë thuhet se posedimi i pronës së kërkuar ka humbur për shkak të rrethanave të ndërlydhura me konfliktin e armatosur që ka ndodhur në Kosovë në vitet 1998/99, duke përmendur 16 qershor 1999 si datë të humbjes, ndërsa e njëjta është uzurpuar nga F. Sh. Në vazhdim, pala ankuese ka thënë se e ka paraqitur një kërkesë për ri-posedimin e pronës në fjalë, në Komisionin për Kërkesa Pronësore Banesore (në tekstin e mëtejme: KKPb). Ajo pretendon se banesa i është ndarë atij më 26 Janar 1999, dhe se ai e kishte fituar posedimin e saj në janar 1999, duke e blerë nga bartësi i të drejtës së ndarjes –Komuna e Ferizajt me 16 Mars 1999 por që KKPb-ja ka vendosur ndryshe,
12. K. M. pretendon se KKPb-ja ka shkelur Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50 dhe Ligjin 03/L-079, në dëm të saj. AKP-ja ka thënë se Sekretaria Ekzekutive nuk ka mundur të verifikojë dokumentet e dorëzuara. Me këtë vendim, Sekretaria ka shkelur të drejtën e pronës private dhe ka shkaktuar dëm të madh material dhe jo material ndaj familjes së saj. Me këtë KKPb-ja ka shkelur Konventat Ndërkombëtare dhe Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut dhe rrjedhimisht edhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës që obligon aplikimin me përparësi të instrumenteve ndërkombëtare.
13. Pala ankuese pretendon se KKPb-ja ka vërtetuar jo saktë gjendjen faktike dhe ka aplikuar gabimisht ligjin material duke theksuar se me veprimin e sajë KKPb-ja ka shkelur të drejtat e

saj njerëzore të mbrojtura me Deklaratën Universale dhe Konventat Ndërkombëtare të cilat aplikohen me përparësi në Kosovë.

14. Mes dokumenteve tjera, ai ka dorëzuar deklaratat e dëshmitarëve të cilët kanë jetuar në të njëjtën ndërtesë dhe të cilët kishin marrë banesa nga Kuvendi Komunal i Ferizajit në të njëjtën siku edhe ai. Ata kanë paraqitur kërkesa në KKP (lëndë absolutisht të njëjta) dhe se KKP-ja ua ka konfirmuar atyre të drejtën pronësore (lëndët DS003510 dhe DS603418).
15. Në ankesë, K.M. ka ofruar prezantim të detajuar të dokumenteve të cilat ai i ka dorëzuar në mënyrë që të vërtetojë pronësinë e tij.
16. Përfundimisht, K. M. konsideron se vendimi i KKP është jo i saktë duke kërkuar nga Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës që ankesën ta aprovoi dhe vendimin e KKP-së ta ndryshoi ashtu që të vërtetoi të drejtën e pronësisë mbi pronën e kërkuar dhe të lëshoi urdhër për kthimin e posedimit të njëjtës parashtruesit të ankesës.

Arsyetimi ligjor

Pranueshmeria e ankesës

17. Ankesa është e afatëshme dhe e pranueshme dhe pse në letrën përcjellëse të lëndës Sekretaria Ekzekutive e AKP-së të datës 08 Janar 2015, thuhet se pala ankuese Vendimin e KKP-së e ka marrë me 15.07.2014 dhe ankesën ka parashtruar me 18 Gusht 2014 në shkresat e lëndës shihet se ankesa në afatin prej 30 ditësh është dorëzuar në njërin nga Zyrat AKP-së sepse e njëjta është dorëzuar me 14. Gusht 2014 në UNCHR, Zyrën për prona në Beograd. Nga kjo mund të konstatohet se ankesa është e pranueshme dhe se e ka paraqitur në afat të parashikuar me dispozitën e nenit 12 par. 1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-79 që parashikohet se ankesa kundër vendimit të KPCC mund të paraqitet brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e pranimit
18. Së pari, pala ankuese në ankesën e saj i referohet vendimit të mëparshëm të marrë nga KKP-ja, lidhur me banesën. Në të vërtetë, K. M. më herët i është adresuar KKP-së, ku ka kërkuar ri-posedimin e banesës, të cilën gjoja e ka humbur gjatë konfliktit. KKP-ja në vendimin e vet të datës 30 prill 2005, HPCC/D/189/2005/C, e ka hedhur poshtë kërkesën sepse M. nuk ka paraqitur ndonjë provë për të dëshmuar se e ka pasur ndonjëherë posedimin

e pronës në fjalë. Për më tepër edhe letërnjoftimi i lëshuar nga autoritetet e Serbisë dëshmon se adresa e fundit e banimit në Kosovë e paraqitëses së ankesës është fshati Talinoc i Muhagjerëve e jo prona e kërkuar.

19. Megjithatë, për të vlerësuar nëse çështja lëndore tashmë është shqyrtuar, jo vetëm qëllimi i paraqitësit të kërkesës duhet të merret parasysh por edhe e tërë gjendja ligjore dhe faktike që është paraqitur.
20. Nuk është kontestuese se paraqitësi i kërkesës po kërkonte në mënyrë të qartë ta marrë ri-posedimin e banesës së njëjtë pranë KKPb-së. Megjithatë, për paraqitjen e një kërkesë në procedurë në shkallë të parë, (para KKPb-së) neni 2.6 i Rregullores së UNMIK-ut 2000/60 dhe neni 1.2 (c) i Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/23 që është përmendur me nenin 7.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60 kërkohet që paraqitësi i kërkesës të jetë posedues i pronës së kërkuar para datës 24 mars 1999. Për ta dëshmuar të drejtën e tij poseduese, pala ankuese ka paraqitur në KKPb dokumentet e njëjta të përmendura në pjesën e parë të këtij aktgjykimi tek çështjet procedurale dhe faktike. Këto dokumente nuk kanë mundur të verifikohen nga KKPb-ja në gjykatë kompetente në Kosovë.
21. Pala ankuese nuk ka sjell ndonjë dëshmi të re në bazë të cilës KKPb-ja do të mohonte rezultatin e verifikimit në procedurën para KKPb-së, prandaj, situata faktike e paraqitur më pas tek KKPb-ja nga pala ankuese ishte e njëjtë; sidoqoftë e drejta pronësore ndaj banesës nuk është shqyrtuar nga DÇPB-ja, në këtë mënyrë pala ankuese përmbushi kërkesat për procedurë para AKP-së.
22. Lidhur me lëndën e paraqitur në AKP, KKPb-ja e bazon vendimin e vet në faktin se Sekretaria Ekzekutive e AKP-së dhe KKPb-ja kanë bërë përsëri verifikimin negativ të dokumenteve, në të cilat Pala Ankuese e bazon kërkesën e tij pronësore. Sekretaria Ekzekutive e KKPb-së nuk ka mundur të sigurojë, *ex officio*, ndonjë provë për ta mbështetur kërkesën e Palës Ankuese. Në bazë të kësaj, KKPb-ja gjeti se Pala Ankuese nuk ka mundur të vërtetojë ndonjë të drejtë pronësore ndaj pronës së kërkuar.
23. Ankesa e Palës Ankuese përsërit të njëjtat pretendime që i ka bërë para KKPb-së dhe KKPb-së. Për më tepër, asnjë provë që më parë është marrë parasysh nga KKPb-ja dhe më vonë nga KPPK-ja nuk është dorëzuar me ankesë.
24. Gjykata Supreme gjen se KKPb-ja ka marrë vendim të drejtë, të bazuar në një procedurë të plotë dhe të saktë. Prandaj, Gjykata Supreme gjen se nuk ka pasur shkelje të së drejtës

materiale dhe as vërtetim të gabuar ose jo të plotë të fakteve. Gjykata Supreme gjen se ankesa është e pa bazuar dhe Vendimi i KKKPK-së i ligjshëm

25. Në bazë të lartcekurave, në pajtim me nenin 13.3 (b) të Ligjit nr. 03/L-079, është vendosur si në diapozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë juridike

26. Në pajtim me nenin 13.6 të Ligjit nr. 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridik

Këshillë juridike

Sylejman Nuredini , Kryetar i kolegjit

Krassimir Mazgalov , Gjyqtar i EULEX-it

Beshir Islami , Gjyqtar

Sandra Gudaityte , Referente e EULEX-it